

VENDIM
Nr. 453, datë 31.7.2025

**PËR SHPALLJEN E ZONËS SË TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK
E TË ZHVILLUESIT TË ZONËS ME VENDNDODHJE NË KASHAR, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 9789, datë 19.7.2007, “Për krijimin dhe funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen “Zonë e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik” të territorit me sipërfaqe 52 140 (pesëdhjetë e dy mijë e njëqind e dyzet) m², pjesë të zonave kadastrale 2105, 2119, me vendndodhje në Kashar, Tiranë, me emërtimin “*Teda Nexus Park Tirana*”, të përbërë nga pasuritë me sipërfaqet përkatëse, sipas listës dhe genplanit, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Shtrirja, kufijtë, pikat e hyrjes dhe të daljes së “Zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik” përcaktohen në genplanin, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Veprimtaritë që do të zhvillohen në “Zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik” janë të llojit:

- a) industri automotive, e automobilave, e mjeteve motorike të ujit, tokës dhe ajrit;
- b) industri e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (ICT);
- c) industri e pajisjeve elektronike, inxhinierike, kimike, minerare, ndërtimi, mekanike dhe elektrike;
- ç) industri farmaceutike, dentare dhe shëndetësore;
- d) industri të tjera prodhuese, përpunuese të pjesshme apo të plota;
- dh) industri agropërpunuese dhe agroprodhuese;
- e) shërbime distribucioni dhe logjistike;
- ë) përpunim dhe magazinim mallrash;
- f) tregtar dhe eksport-import;
- g) industri të tjera, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

4. Periudha e funksionimit të zonës është 35 (tridhjetë e pesë) vjet me të drejtë përsëritjeje deri në 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vjet.

5. Zhvillues i “Zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik” shpallet bashkimi i shoqërive “*Astral*” sh.p.k. dhe “*Capital Resources*” sh.p.k.

6. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Agjencia Shtetërore Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

**LISTA E PASURIVE QË DO TË PËRFSHIHEN NË “TEDA NEXUS PARK TIRANA”,
KASHAR, TIRANË**

ZK	Numri i pasurisë	Sipërfaqja totale e pasurisë (m²)	Pronësia
2105	1156/47	9484	“ASTRAL” sh.p.k.
2105	1156/17	1600	“ASTRAL” sh.p.k.
2119	156/4/12+0	500	“ASTRAL” sh.p.k.
2119	156/16	19831	“ASTRAL” sh.p.k. (kontratë sipërmarrjeje nr. 118 rep., nr. 73 kol., datë

			13.4.2022).
2119	156/14	15300	“ASTRAL” sh.p.k. (kontratë sipërmarrjeje nr. 118 rep., nr. 73 kol., datë 13.4.2022).
2105	1156/1	5425	“ASTRAL” sh.p.k. (kontratë sipërmarrjeje nr. 118 rep., nr. 73 kol., datë 13.4.2022).
		52,140	

GENPLANI I “ZONËS SË TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK”

